



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES

## AGJENCIA PUBLIKE E AKREDITIMIT TE ARSIMIT TE LARTE

---

Rruga "Lekë Dukagjini", Nr. 5, Tiranë

Tel&Fax: 257 954/266 302/225 322

E-mail: [aaal@albmail.com](mailto:aaal@albmail.com)

Website: [www.aaal.edu.al](http://www.aaal.edu.al)



### RAPORT

### PER VEPRIMTARINE E

### AGJENCISE PUBLIKE TE AKREDITIMIT TE ARSIMIT TE LARTE

### PER VITIN 2007

**Tirane, 22 Janar 2008**

## RAPORT PER VEPRIMTARINE E AGJENCISE PUBLIKE TE AKREDITIMIT TE ARSIMIT TE LARTE PER VITIN 2007

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në veprimtarinë e saj të përgjithshme mbështetet në aktet kryesore ligjore në fushën e Arsimit të Lartë dhe akte të tjera nënligjore si dhe rregullore e procedura të funksionimit të brendshëm e në marrëdhënie me të tjerë, dhe në veçanti, në Planin e Parashikuar të veprimtarive për vitin 2007.

Drejtimet kryesore të punës gjatë vitit 2007 kanë mbuluar fushat si më poshtë:

1. Vlerësimet në IAL Publike dhe Private
2. Vlerësime të institucioneve dhe programeve të arsimit të lartë
3. Vlerësime analitike-krahasuese dhe të sistemit të arsimit të lartë
4. Rishikim dhe përmirësim të bazës ligjore dhe nënligjore të sigurimit të cilësisë, përfshirë kontributin për hartimin e ligjit të ri të arsimit të lartë
5. Mbështetja e aktivitetit të Këshillit të Akreditimit
6. Aktivitete botuese dhe informuese, përfshirë website e ri
7. Aktivitete si konferenca e workshope me aktorë të ndryshëm të arsimit të lartë
8. Pjesëmarrje në aktivitete brenda e jashtë vendit me referime e shpërndarjen e informacionit dhe përvojës së agjencisë edhe në vende të tjera
9. Forcimin e bashkëpunimit me organizma ndërkombëtare në fushën e Sigurimit të Cilësisë
10. Përdorimin me eficiencë dhe efektivitet më të lartë të burimeve njerëzore e financiare

### **BAZA LIGJORE DHE NENLIGJORE PER SIGURIMIN E CILESISE NE ARSIMIN E LARTE:**

#### **a) Baza ligjore dhe nënligjore për veprimtaritë kryesore të Sistemit të Akreditimit**

Ligji Nr.9741, datë 21.5.2007: “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”

VKM Nr.303 Datë datë 1.7.1999: “Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë” i ndryshuar me VKM Nr.611 datë 04.12.2002 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.303 datë 01.07.1999 ‘Për krijimin e sistemit të Akreditimit në Arsimin e Lartë’

VKM Nr.156 datë 22.03.2001:“Për shkollat e larta jopublike në Republikën e Shqipërisë”

Udhëzim i MASH Nr.4 datë 28.02.2006: “Për caktimin e tarifave të vlerësimit dhe akreditimit për shkollat e larta jopublike”

Udhëzim Nr.30, datë 26.9.2007: “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë ose programeve të studimit, në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve”

#### **b) Baza ligjore për pagesën e punonjësve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm të APAAL:**

Ligj Nr.7961 datë 12.07.1995: “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar

VKM Nr.478 datë 18.07.2007: “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”

Udhëzimin Nr.12 Datë 15.11.2006:“Mbi punonjësit që paguhen jashtë numrit të punonjësve buxhetorë të miratuar për ministrinë dhe institucionet buxhetore” i ndryshuar

VKM Nr. 720 datë 29. 11. 1995: “Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore shtetërore”

VKM Nr.120 datë 27.01.1997: “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor”

### **c) Akte të brendshme të APAAL:**

Procedura për vlerësimin dhe akreditimin e institucioneve dhe programeve në Arsimin e Lartë  
Statuti i Këshillit të Akreditimit

Kriteret dhe Procedura për vlerësimin e Programeve të Reja të Studimit Bachelor, në IAL Publike dhe Private

Kriteret dhe Procedura për vlerësimin e Programeve të Reja të Studimit Master, në IAL Publike dhe Private

Udhëzues për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë

Udhëzues për Vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë

Aspekte dhe tregues të Cilësisë në Arsimin e Lartë

Rregullore e brendshme e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë

Përshkrimet për funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e punonjësve të APAAL

## **A - PJESA PERSHKRIMORE**

## **PJESA A**

### **1. Vlerësimet në IAL Publike dhe Private**

#### **1.1. Vlerësime në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik**

Mbështetur në Planin e Veprimtarive për vitin 2007, APAAL kreu disa vlerësime në nivel institucional dhe në nivel programesh në disa Institucione Publike të Arsimit të Lartë; gjithsej 12 vlerësime institucionale dhe 35 vlerësime diplomash. Këtu nuk përfshihen vlerësimet institucionale të kryera në të gjitha IAL Publike në nivel sistemi (shih pikën 2 më poshtë). Këto vlerësime kanë përfshirë Universitetin e Tiranës, Universitetin e Elbasanit, të Shkodrës, Vlorës, Gjirokastrës dhe Korçës. Të dhënat e plota për këto vlerësime, llojin, numrin e përgjithshëm dhe shpërndarjen sipas universiteteve ndodhet në Tabelat 1.1, 1.2 dhe diagramat 1.1 dhe 1.2.

Për herë të parë gjatë 2007, si kërkesë e ligjit të ri të arsimit të lartë, APAAL ka vlerësuar disa kërkesa të IALve Publike për hapjen e kurseve të studimit Master. Të dhëna të hollësishme për këto vlerësime ndodhen në Pjesën B, Tabela 1.3 dhe Diagrama 1.3.

#### **1.2. Vlerësime në Institucionet e Arsimit të Lartë Privat**

Mbështetur në kërkesat dhe ndryshimet që sjell ligji i ri i Arsimit të Lartë dhe Udhëzimit Nr.30, date 26.9.2007 i Ministrit dhe Arsimit dhe Shkencës, si dhe Procedurës së re të agjencisë për vlerësimin paraprak të programeve në Institucionet Private të Arsimit të Lartë, në periudhën tetor-dhjetor 2007 janë vlerësuar, me kërkesë të MASH, 73 programe të reja studimi të kërkuara nga 16 IAL private egzistuese ose të reja.

Përveç vlerësimeve të mësipërme, gjatë 2007 janë kryer dhe vlerësimet e para për akreditim të programeve të kërkuara nga Universiteti “Zoja Këshillit të Mirë” dhe vlerësimi i parë institucional për akreditim i Shkollës së Lartë të Kinematografisë “Marubi” si dhe programeve të saj të studimit. Të dhëna të hollësishme për këto vlerësime sillen në Tabelat 1.2.1 dhe 1.2.2 si dhe diagramat përkatëse shoqëruese të tabelave.

Në Tabelën 1.2.2 dhe diagramat përaktëse të Pjesës B, janë sjellë gjithashtu të dhënat e rezultateve të vlerësimit për këto programe të reja studimi.

### **2. Vlerësime të analitike ose të sistemit të arsimit të lartë**

Gjatë vitit 2007, APAAL ka kryer katër vlerësime analitike-krahasuese dhe të sistemit të arsimit të lartë:

#### **2.1: Vlerësimin institucional deri në nivel departamenti të të gjitha universiteteve publike në vend**

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, mbështetur në të dhënat zyrtare të grumbulluara gjatë viteve akademike 2005-2006 dhe 2006-2007 dhe pasi i riverifikoi ato gjatë muajit tetor-nëntor 2007, hartoi strukturat organizative deri në nivel departamenti për të gjitha IAL egzistuese Publike. Në këtë analizë, për natyrën e tyre dhe standardet specifike që kanë, nuk u përfshinë Akademia e Arteve, Akademia e Sporteve, Akademia e Policisë dhe Universiteti Ushtarak.

Të dhëna të hollësishme dhe detaje të metodës së përdorur për këtë analizë ndodhen në Pjesën B, pika 2.1 dhe në Pjesën C, Aneksi 2.1.

Të dhënat e grumbulluara përfshinin: a) IAL me emërtimin përkatës; b) organizimin në fakultete dhe njësi të tjera; c) numrin e fakulteteve dhe/ose njësive të tjera me emërtimin përkatës; d) organizimin e çdo fakulteti në departamente dhe/ose njësi të tjera përbërëse me emërtimin përkatës.

## 2.2: Vlerësim analitik për stafet akademike të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë

Në këtë vlerësim u përdorën të dhëna analitike për Stafet akademike në IAL publike, dhe konkretisht të dhëna institucionale si: nr i departamenteve, kualifikimi i stafit akademik të brendshëm, nr i përgjithshëm i stafit . Të dhëna të plota të kësaj analize ndodhen në Aneksin 2.2.

## 2.3: Vlerësim analitik-krahasues për njësitë e arsimit të lartë dhe diplomat në fushën e mësuesisë

Këtu u morrën në studim ato IAL dhe njësi përbërëse të tyre që ofrojnë programe studimi për përgatitjen e mësuesve si dhe diplomat përkatëse. Për këtë u përdorën tregues të tillë si: nr. i stafit të B/J, shkalla e kualifikimit të stafit, raporti Staf i Brendshëm/student dhe raporti Staf i përgjithshëm/student . Përmbledhja në formë tabelash e diagramash jepet në Aneksin 2.3.

## 2.4: Analizë e sistemit të Arsimit të Lartë Privat

Në këtë vlerësim u shqyrtuan në IAL Private operuese disa indikatorë: nr. i IALP të licensuara, licensimi i tyre në vite, sa prej tyre janë të akredituara , sa janë në proces akreditimi; nr.i studentëve në IALP krahasuar dhe me totalin e studentëve ne IAL, dhe një analizë të fushave në të cilat operojnë dhe ofrojnë programe studimit këto IALP . Të dhënat e hollësishme të këtij vlerësimi ndodhen në Aneksin 2.4

## 3. Rishikim dhe përmirësimi i bazës ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurimit të cilësisë

Gjatë 2007 APAAL ka kontribuar për hartimin dhe finalizimin e Ligjit të Ri të Arsimit të Lartë Nr.9741, i 21.5.2007, që hyri në fuqi më 1.07.2007.

Në mbështetje dhe sipas kërkesave të këtij ligji APAAL në konsultim dhe me ekseptë ligjorë, ka përgatitur draftin e tre akteve nënligjore që lidhen me Sigurimin e Cilësisë: akt-rregulloren për funksionimin e Agjencisë, aktin për funksionimin e KA, aktin për tarifën dhe pagesat për vlerësimin dhe akreditimin, si dhe strukturën e re të agjencisë. Po në mbështetje dhe zbatim të këtij ligji janë përgatitur, në bashkëpunim edhe me Këshillin e Akreditimit, akte të reja procedurash për vlerësimin dhe akreditimin.

Të dhënat, lista e këtyre akteve dhe detaje të këtyre akteve ndodhen në Pjesën B, pika 3.

## 4. Mbështetja e të gjithë veprimtarisë të Këshillit të Akreditimit

Një nga detyrat e agjencisë është dhe mbështetja që ajo i jep Këshillit të Akreditimit. Agjencia organizon mbledhjet e Këshillit, përgatiti axhendën e takimeve, programin e mbledhjeve, përgatit dhe shpërndan informacionin antarëve të këshillit dhe përgatit dokumentin final në emër të Këshillit

përpara se ai të shqyrtohet e miratohet. Agjencia kryen gjithashtu të gjithë korrespondencën me institucionet e tjera në emër të këshillit.

Gjatë 2007, KA ka zhvilluar ...mbledhje, ka shqyrtuar një numër të madh vlerësimesh individuale e analitike-sistematike dhe ka hartuar e dërguar në MASH një sërë dokumentash e rekomandimesh.

Në Pjesën B, pika 4, ndodhen të dhëna të hollësishme për këtë aktivitet të mbështetur nga APAAL.

## **5. Aktivitete botuese dhe informuese të APAAL**

- Gjatë 2007, agjencia ka përgatitur e shpërndarë si në mënyrë individuale e institucionale, ashtu dhe përmes aktiviteteve që ka organizuar me aktorë të ndryshëm të arsimit të lartë një sërë dokumentash informuese, njohëse e sensibilizuese në fushën e cilësisë si: procedura të reja apo versione të rishikuara në përputhje me ligjin e ri të procedurave ekzistuese, procedura të reja që diktohen nga ligji i ri, dokumenta të rëndësishëm ndërkombëtarë të fushës si dhe udhëzues për aplikimin për vlerësime, si kusht për procedura të rregullta e të paranjohura. Një pjesë e mirë e këtyre dokumentave janë botuar në formë fletëpalosjesh e broshurash. Në Pjesën C, Aneksi 5 ndodhet lista e botimeve të agjencisë apo që janë në proces botimi.
- Gjatë 2007 është riformatuar website i agjencisë në një formë të re dhe me informacion të ri. Ky proces po përfundon këto ditë në versionin e tij anglisht. Në Pjesën B, pika 5, ndodhet një kopje e faqes kryesore të website të ri të agjencisë.

## **6. Aktivitete të organizuara nga APAAL si konferenca, seminare e workshope me aktorë të ndryshëm të arsimit të lartë**

Janë organizuar disa takime kryesisht me përfaqësues të IAL për çështje që lidhen me Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë Publik dhe Privat si dhe për fusha specifike si ajo e Mësuesisë. Në Pjesën B, pika 6, ndodhen të dhëna e detaje mbi këto aktivitete.

## **7. Pjesëmarrje në aktivitete brenda e jashtë vendit me referime e shpërndarjen e informacionit dhe përvojës së agjencisë edhe në vende të tjera**

Pjestarët e stafit të agjencisë kanë marrë pjesë në disa aktivitete ndërkombëtare të fokusuar në Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Pjesëmarrja ka qenë aktive dhe në shumicën e tyre, përfaqësues të agjencisë kanë mbajtur referime kryesore duke shpërndarë edhe përvojën tonë në vende të tjera.

Në Pjesën B, pika 7, gjendet një listë e aktiviteteve dhe referimet që janë mbajtur në emër të agjencisë në këto aktivitete.

## **8. Forcimin e bashkëpunimit me organizma ndërkombëtare në fushën e Sigurimit të Cilësisë**

Gjatë 2007, APAAL ka shtuar kontaktet dhe ka forcuar lidhjet dhe bashkëpunimin me organizma e rrjete të rëndësishme ndërkombëtare që operojnë në fushën e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Tashmë lidhjet janë bërë të vazhdueshme me Organizatën Europiane të Sigurimit të Cilësisë (ENQA); disa herë APAAL ka marrë pjesë në aktivitete të ENQAs me kërkesën e kësaj të fundit.

APAAL ndërkohë po përgatit një raport vetvlerësimi i cili do shërbejë si bazë për të kërkuar një vlerësim të jashtëm ekespertë të huaj që do sillen nga ENQA.

APAAL ka gjithashtu lidhje më të mira me Rrjetin Ndërkombëtar të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë INQAAHE dhe atë Rajonal të Europës Qendrore e Lindore CEENetëork. Ky bashkëpunim solli si rezultat emërimin e Drejtores së Agjencisë Dhurata Bozo, si antare të kooptuar të Bordit të INQAAHE si përfaqësues dhe dhënëse e CEE Networkë në këtë bord. Po si rezultat i këtij bashkëpunimi, Agjencia do organizojë Asamblenë e Përgjithshme të CEE Netëork, në 23-24 maj 2008 në Shqipëri.

Për herë të parë janë vendosur kontakte dhe me Drejtorinë e Arsimit të UNESCOs dhe me Rrjetin ERI SEE; me këto dy organizma është marrë përsipër të mbështeten nisma për krijimin e rrjeteve subrajonale me Agjencitë e Sigurimit të Cilësisë.

## **9. Përdorim me eficiencë dhe efektivitete më të lartë të burimeve financiare**

Në Pjesën B, pika 7, ndodhen diagramat e buxhetit total të APAAL për vitin 2007, shpërndarja sipas zërave kryesorë financiarë, përdorimi i shpenzimeve operative dhe raporti midis shpenzimeve operative që lidhen direkt me aktivitetet specifike të APPAL në raport me shpenzimet e përgjithshme operative, si indikator i eficiencës dhe efektivitetit të përdorimit të financave.



**PJESA B -**  
**TE DHENA DHE TREGUES PER AKTIVITETET KRYESORE**


## PJESA B: TE DHENA DHE TREGUES PER AKTIVITETET KRYESORE


### 1. Vlerësimet në IAL Publike dhe Private

**Tabela 1.1.1: Vlerësimet e kryera në institucionet Publike të arsimit të lartë sipas universiteteve**

<b>VLERESIME PERIODIKE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE</b>				
	<b>Universiteti</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Vlerësim Institucional</b>	<b>Diploma të vlerësuara</b>
I	Universiteti "A. Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shk. të Natyrës	1	3
		Fakulteti Ekonomik	1	3
		Dep i Sh. Sociale	0	3
II	Universiteti "L. Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shk. të Natyrës	1	3
		Fakulteti Ekonomik	1	3
		Fakulteti i Drejtësisë	1	1
		Fakulteti i Shk. të Edukimit	0	1
III	Universiteti "F. S. Noli" Korçë	Fakulteti i Mësuesisë	0	2
		Fakulteti i Bujqësisë	1	3
		Fakulteti Ekonomik	1	4
IV	Universiteti "E. Çabej" Gjirokastrë	Fakulteti i Sh. të Natyrës	1	3
		Dep Ekonomik	0	3
V	Universiteti "I. Qemali" Vlorë	Fakulteti Ekonomik	1	2
		Dega Juridike-FE	0	1
		Riorganizimi Institucional	1	0
VI	UPT	Krijimi i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit	1	0
VII	UT	Vlerësim për hapjen e Filiali KUKES	1	0
	<b>Gjithsej</b>		<b>12</b>	<b>35</b>

**Diagramat e tabelës 1.1.1**







**Tabela 1.1.2: Rezultatet e Akreditimit (nga KA) në institucionat publike të arsimit të lartë sipas universiteteve**

Lloji i vlerësimit/akreditimit	Institucioni	Diploma
Akreditim Pozitiv	2	1
Akreditim me Kusht	2	13
Akreditim Negativ	0	0
Akreditime në Proces	5	21
<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>35</b>

**Diagramat e tabelës 1.1.2**






**Tabela 1.1.3**

	<b>IAL</b>	<b>Bachelor</b>	<b>MNP</b>	<b>Specializim afatgjatë</b>
	Akademia e Sporteve	1		
Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Mjekësisë			2
	Fakulteti i Histori-Filologjisë		2	
	Fakulteti i Infermierisë		3	
UK	Fakulteti i Mësuesisë		1	
	Fakulteti i Bujqësisë		1	
USH	Fakulteti Ekonomik		1	
UGJ	Fakulteti i Shk. Shoqërore		1	
UE	Fakulteti Ekonomik		2	
	Fakulteti i Gj. të Huaja		3	1
	Fakulteti i Infermierisë		5	
	<b>Gjithsej</b>	<b>1</b>	<b>19</b>	<b>3</b>

**Diagrama 1.1.3.**




**Tabela 1.2.1: Vlerësime paraprake të programeve të reja të kërkuara nga Institucione Private të Arsimit të Lartë**

IAL Private	Nr.i Diplomave	LLOJI i Diplomës		
		Bachelor	Dip.Niv.Dytë	Ma Niv.Parë
Universiteti European i Tiranës	4	4	0	0
Aldent	1	0	1	0
EPOKA University	7	7	0	0
S&P Qiriaz	6	6	0	0
ËISDOM University	2	2	0	0
Luigj Benussi	1	2	0	0
ISSAT (Inst. i Studimeve strategjike)	6	0	0	6
Univ. Amerikan i Tiranës (Medikom)	22	14	8	0
Nëna Mbretëreshë Geraldinë	5	5	0	0
Univ. "MESDHETAR" i Tiranës.	3	3	0	0
Shkolla e Lartë Jopublike "ILLYRIA"	2	2	0	0
Universiteti "DEMOKRACIA"	6	6	0	0
Klinika e syve "UZLLOVA"	2	0	0	2
"University of Neë York"	2	0	0	2
Kolegji Prof. "Ivoclar Vivadent & Partners"	1	0	0	0
Universiteti "Kristal"	3	2	0	1
<b>Gjithsej</b>	<b>73</b>	<b>53</b>	<b>9</b>	<b>11</b>

**Tabela 1.2.3: Vlerësime për akreditimin e parë Institucional dhe/ose Programeve të Institucioneve Private Ekzistuese të Arsimit të Lartë**

<b>VLERESIME të INSTITUCIONEVE Private</b>				
	Universiteti/ Shkolla	Vlerësim Institucional	Diploma të vlerësuara	
I	Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Luarasi"	1	Bachelor 1	Master Niv. Parë
II	Universiteti "Zoja e Këshillit të Mirë"	0		1
III	Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Marubi"	1	3	
	<b>Gjithsej</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>1</b>




**Diagrama e Tabelës 1.2.1.**



**Tabela 1.2.2: Lloji i Vlerësimeve të programeve të reja të kërkuara nga Institucione Private të Arsimit të Lartë**

Niveli i Diplomave të vlerësuara	Vlerësim pozitiv	Vlerësim pozitiv me Kusht	Vlerëim Negativ	Kthim për Pl. Dok.	Totali
Bachelor	20	23	7	3	53
DND	1	0	8	0	9
Master NP	4	6	1	0	11
<b>Vlerësime Gjithsej</b>	<b>25</b>	<b>29</b>	<b>16</b>	<b>3</b>	<b>73</b>

## Diagramat e Tabelës 1.2.2



## 2. Vlerësime analitike ose të sistemit të arsimit të lartë

2.1. Në të dhënat në nivel departamenti u përfshinë dy tregues: numri i personelit akademik të brendshëm (PAE) për çdo departament dhe numri i atyre që mbajnë tituj/grada (T/G).

Të dhënat e mësipërme u krahasuan me standardet e strukturave dhe të stafit, të parashikuara në Ligjin Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe përkatësisht në nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, dhe 12.

Standardet bazë, përkundrejt të cilave u bë vlerësimi ishin:

- Çdo IAL duhet të ketë të paktën dy fakultete
- Çdo fakultete duhet të ketë të paktën tre departamente, ndër të cilët një njësi me status të ndryshëm nga i departamentit
- Çdo departament duhet të ketë të paktën 7 personel akademik efektiv
- Çdo departament duhet të ketë të paktën 3 PAE me tituj e grada.

Të dhënat e krahasuara u hodhën në diagramat ku paraqiten strukturat, emërtimi i njësive deri në nivel departamenti dhe të dhënat e stafit të brendshëm dhe kualifikimi i këtij të fundit për çdo departament. Në rastet e mosplotësimit të standardeve të strukturave, struktura përkatëse është shënuar me ngjyrë të kuqe; në rastet e mosplotësimit të standardeve të stafit akademik në departamente, treguesi përkatës është në ngjyrë të kuqe. Për të gjitha strukturat dhe treguesit që plotësohet standardi përkatës është përdorur ngjyra e gjelbër, ndërsa për ato ky njëri ose tjetri nga standardet nuk plotësohet janë përdorur gërma të zeza.

Të dhënat e mësipërme për çdo IAL Publike ndodhen në Aneksin 2.1.

2.2: Të dhëna analitike për Stafet akademike në IAL publike, të dhëna për: nr i departamenteve, kualifikimi i stafit akademik të brendshëm, nr i përgjithshëm i stafit . Të dhëna të detajuara ndodhen në Aneksin 2.2.

2.3: Diplomat e mësuesisë në IAL-Publike në vend; nr. i stafit të B/J, kualifikimet e ture ; raporte Staf i B/student dhe Staf i përgjithshëm/student Të dhëna të detajuara ndodhen në Aneksin 2.3.

2.4: Analizë e sistemit të Arsimit të Lartë Privat, nr. i IALP të licensuara, licensimi i tyre në vite, sa janë të akredituara , në proces akreditimi nga nr. total i IALP; nr.i studentëve në IALP krahasuar dhe me totalin e studentëve ne IAL publike; fushat në të cilat operojnë këto IALP Të dhëna të detajuara ndodhen në Aneksin 2.4.

2.5: Draft- standardet e Arsimit të Lartë paraqitur në takimin e organizuar nga AAAL me KALSH (dhjetor 2007)

## 3. Rishikim dhe përmirësim të bazës ligjore dhe nënligjore të sigurimit të cilësisë, përfshirë kontributin për hartimin e ligjit të ri të arsimit të lartë

3.1: Ligji Nr.9741, datë 21.5.2007: “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”

3.2: Udhëzim Nr.30, datë 26.9.2007: “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë ose programeve të studimit, në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve”



- 3.3: Draft i Projektvendimit për “Rregulloren për funksionimin e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë“
- 3.4: Draft i Projektvendimit për “Ngritjen dhe funksionimin e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë“
- 3.5: Draft i Projektvendimit për “Pagesat dhe tarifat për Vlerësimin dhe akreditimin në arsimin e Lartë“
- 3.6: Draft Urdhër “Për Strukturën dhe organikën e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë“
- 3.7: Kriteret dhe Procedura për vlerësimin e Programeve të Reja të Studimit Bachelor, në IAL Publike dhe Private
- 3.8: Kriteret dhe Procedura për vlerësimin e Programeve të Reja të Studimit Master, në IAL Publike dhe Private

#### **4. Mbështetja e aktivitetit të Këshillit të Akreditimit**

Këshilli i Akreditimit ka zhvilluar 15 mbledhje gjatë vitit 2007. Ai ka marrë në shqyrtim raportet e vlerësimit për rreth 30 diploma dhe 9 vlerësime institucionale në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik si dhe 3 në Arsimin e Lartë Privat. Këshilli ka shqyrtuar e dhënë mendime dhe për vlerësimet institucionale në sistem të të gjitha universiteteve publike. Në Aneksin 4 ndodhet një tabelë me aktivitetet kryesore mbështetëse të Agjencisë për Këshillin e Akreditimit.

#### **5. Aktivitete botuese dhe informuese; website i APAAL**

- 5.1: Si aplikohet për një institucion të ri të arsimit të lartë apo një program të ri studimi ( fletëpalosje e cila do të prezantohet në një takim me IAL publike dhe private ne vend pas përfundimit të zgjedhjeve e re); është në shtyp
  - 5.2: Ripunim i “Procedurës për vlerësimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë”; në proces
  - 5.3: Procedurat dhe kriteret për vlerësimin e programeve të reja të studimit (të ciklit të parë të studimit -Bachelor) në IAL e reja dhe ekzistuese private dhe publike (bllok procedurash; në përfundim)
  - 5.4: "Udhëzime për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin nderkufitar" UNESCO; broshurë
  - 5.5: Procedurat dhe kriteret për vlerësimin e programeve të reja të studimit (të ciklit të dytë të studimit - Master) në IAL e reja dhe ekzistuese private dhe publike (bllok procedurash; në përfundim)
  - 5.6: Formatet standarde për vlerësimin e programeve të reja të studimit të ciklit të parë dhe të dytë në IAL Publike dhe Private
  - 5.7: Fletëpalosje e APAAL (e ripunuar, e përvitshme)
  - 5.8: Standarde dhe Udhëzime për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (ENQA); në proces ribotimi.
- Të dhëna të detajuara ndodhen në Aneksin 5.

## **6. Aktivitete të organizuara nga APAAL; konferenca, seminare e workshope me aktorë të ndryshëm të arsimit të lartë**

- 28 Mars 2007; Seminar: “Perspektiva e përgatitjes së mësuesve në përputhje me standardet europiane”; në bashkëpunim me Qendrën për Arsim Demokratik (QAD).
- 15 Maj 2007; Seminar: “Standardet Ndërkombëtare për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë: “Sigurimi i Brendshëm dhe Arsimi i Lartë Ndërkufitar”; mbështetur nga Fondacioni SOROS
- 25-26 Shtator 2007; Workshop: “Sigurimi i Cilësisë në Arsimin e Lartë Jopublik”; në bashkëpunim me Austrian Development Cooperation
- 27 Shtator 2007; Takim Pune me të gjithë Ekspertët e Vlerësimit të Jashtëm, bashkëpunëtorë të AAAL
- 13 Dhjetor 2007; Seminar “Standartet e Cilësisë në Arsimin e Lartë”
- 14 Dhjetor 2007; Workshop: “Cilësia në Arsimin e Lartë dhe roli i Studentëve”




## **7. Pjesëmarrje në aktivitete brenda e jashtë vendit me referime e shpërndarjen e informacionit dhe përvojës së agjencisë edhe në vende të tjera**

- 23-24 Mars 2007; Konferencë: “National Policies for Integration in the European Higher Education Area”; Prishtinë, Kosovë; morën pjesë Dhurata Bozo, Çlirim Duro, Renata Qatipi
- 4-5 Qershor 2007; Armeni; Seminar “Sigurimi i Cilësisë në Arsimin e Lartë”; morën pjesë Dh.Bozo
- 28-29 Qershor 2007; Zagreb, Kroaci; Seminar: “Akreditimi në Arsimin e Lartë në Europën Juglindore”; morën pjesë Dhurata Bozo
- 28-29 Shtator 2007; Tivar, Mal i Zi; Seminar: “Vlerësimi kombëtar dhe ndërkombëtar në arsim”; morën pjesë Çlirim Duro
- 8-10 Tetor 2007; Seminar: “Arsimi dhe Trajnimi Profesional e Teknik”; Bukuresht, Rumani; morën pjesë Dhurata Bozo)
- 1-2 Nëntor 2007; Konferencë e Rajonit të Europës Juglindore në kuadrin kombëtar të kualifikimeve; Beograd, Serbi; morën pjesë Dhurata Bozo
- 08-11 Nëntor 2007; Konferencë: “European Quality Assurance and the situation in the SEE Region”; Sofie, Bullgari; morën pjesë Dhurata Bozo, Renata Qatipi
- 15-17 Nëntor 2007; Konferencë: “2<sup>nd</sup> Quality Assurance Forum”; Romë, Itali; morën pjesë: Dhurata Bozo, Etleva Vasha

## **9.Përdorimi i burimeve njerëzore e financiare**

### **Diagramat 8.1, 8.2 dhe 8.3:**

Buxheti i APAAL për vitin 2007 sipas zërave kryesorë financiarë; buxheti sipas nënzërave të 602; zërat kryesorë të lidhur me aktivitetet kryesore në raport me shpenzimet operative



## **Pjesa C – ANEKSE**

**Aneks 6 : Të dhëna për veprimtarinë e Këshillit të Akreditimit për vitin 2007**

<b>RAPORTET E VLERËSIMIT.MENDIMET DHE REKOMANDIMET DREJTUAR MASH</b>	<b>MBLEDHJA DHE DATA E SHQYRTIMIT NGA KA</b>
Analiza e punës së AAAL dhe Këshillit të Akreditimit për vitin 2006	19.01.2007
Plani i Veprimtarisë të APAAL për vitin 2007.	13.02.2007
<p>Raportet e Vlerësimit te F.SH.N të Universiteteve të Korçës, Vlorës, Gjirokastrës, Elbasan, Shkodër.</p> <p>Mendimet dhe Rekomandimet për Vlerësimin dhe Akreditimin e Degës Biologji-Kimi dhe Matematikë-Fizikë (Matematikë-Informatikë) në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti “E.Çabej”, Gjirokastër</p> <p>Mendime dhe Rekomandime për Akreditim Institucional dhe të Diplomave të Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin “L.Gurakuqi”, Shkodër.</p>	<p>05.04.2007-19.06.2007</p> <p>05.04.2007-26.06.2007</p>
<p>Raportet e Vlerësimit të F.SH.N të Universiteteve të Korçës, Vlorës, Gjirokastrës, (Elbasan, Shkodër)</p> <p>Paraqitja e dokumentacionit dërguar Ministrit dhe MASH-it nga AAAL dhe KA gjatë viteve 2004-2007</p> <p>Mendime dhe Rekomandime për Akreditimin e Diplomës “Mësues Matematike” për Shkollat e Mesme , “Fakulteti i Mësuesisë” Universiteti “F.S.Noli”, Korçë.</p> <p>Mendime dhe Rekomandime për Akreditim Institucional dhe të Diplomave të Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin “A.Xhuvani”, Elbasan.</p>	<p>23.05.2007</p> <p>23.05.2007-</p> <p>26.06.2007</p>
<p>Raportet e Vlerësimit të Jashtëm për Shkollën e Lartë jopublike “Luarasi”.</p> <p>Mendime dhe Rekomandime për Vlerësimin dhe Akreditimin e Degës Drejtësi e cila lëshon Diploma me titullin “Jurist” në Shkollën e Lartë Universitare Jopublike “Luarasi”</p> <p>Mendime dhe Rekomandime për Vlerësimin dhe Akreditimin e degës Matematikë-Fizikë në Departamentin Ndërfakultetor të Mësuesisë në Universitetin “I.Qemali”, Vlorë.</p>	<p>14.06.2007</p>
Rekomandimet e KA-së për Fakultetet e Shkencave të	19.06.2007

Natyrës Vlorë, Gjirokastrër.	
Mendime dhe Rekomandime për Vlerësimin dhe Akreditimin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës për Fakultetet e Shkodrës, Elbasanit	02.07.2007
Raporti i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për Fakultetin Bujqësor, Korçë.  1.Raportet e Vlerësimit të Jashtëm për Fakultete e Ekonomisë të Universiteteve të Shkodrës, Korçës, Elbasanit, Vlorës dhe Gjirokastrës.  2.Mendime dhe Rekomandime për Vlerësimin dhe Akreditimin Institucional dhe të Diplomave të Fakulteteve të Ekonomisë të Universiteteve të Shkodrës, Korçës, Elbasanit, Vlorës dhe Gjirokastrës.	09.07.2007
Në axhendën e kësaj date nuk ka patur për diskutim apo miratim në KA Raporte të Vlerësimit të Jashtëm apo Rekomandime	07.09.2007
1.Raporti i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për Fakultetin Bujqësor, Korçë. 2.Mendime dhe Rekomandime për Akreditimin Institucional dhe të Diplomave të Fakultetit të Bujqësisë në Universitetin “F.S. Noli”, Korçë  1.Raporti i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për Degën Filozofi-Sociologji të Fakultetit të Mësuesisë, Korçë. 2. Mendime dhe Rekomandime për Vlerësimin dhe Akreditimin e Degës Filozofi-Sociologji në Fakultetin e Mësuesisë në Universitetin “F.Noli”, Korçë.	6.07.2007
1.Mendime dhe Rekomandime për Vlerësimin e Filialit të Fakultetit Ekonomik , Universiteti i Tiranës, Dega Administrim Biznes, Qyteti Kukës.  2.Raporti AAAL për Shqyrtimin e Hapjes së Filialit të fakultetit Ekonomik	08.11.2007
1.Raporti i Vlerësimit të Jashtëm të Masterit të Nivelit të Parë të Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Zonja e Këshillit të Mirë” 2. Draft- Rekomandimet për Akreditimin e Diplomës Master në Menaxhim financiar dhe Menaxhim risku (MNP), ZKM.	21.11.2007
Analiza e Strukturave në IAL Publike dhe Propozime për ristrukturimin e tyre bazuar në LAL.  Raportet e Vlerësimit të Jashtëm për Fakultetin Ekonomik të Universiteteve të Korçës, Shkodrës, Vlorës, Gjirokastrës dhe Elbasanit  Draft-Rekomandimet e KA-së për diplomat e fushave	27.11.2007

<p>ekonomike në Universitetet e rretheve Korçë, Shkodër, Vlorë, Gjirokastër dhe Elbasan</p> <p>2. Mendime dhe Rekomandime për Akreditimin e Diplomës Master në Menaxhim financiar dhe Menaxhim risku (MNP), ZKM</p>	
<p>Raporti i Masterit “Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm” të Fakultetit Ekonomik, Universiteti “L. Gurakuqi” Shkodër</p> <p>Mendime dhe Rekomandime për Vlerësimin dhe Akreditimin Institucional të Fakulteteve Ekonomike</p>	<p>11.12.2007</p>